

VALENTIN KRASNOGOROV

KNAQËSIT E TRADHËTIS

Прелести измены

TRI HISTORI PËR TU LUJTUR NË TEATËR

PËRKTHEU:

MEHMET XHELILI

Contacts :

Valentin Krasnogorov

WhatsApp +7-951-689-3-689

Phone (972)-53-527-4146, (972) 53-52-741-42

e-mail: valentin.krasnogorov@gmail.com

Website: <http://krasnogorov.com/english/>

© Valentin Krasnogorov

Tabela e përmbajtjes

TË PASNESËRMEN	4
LEZETET E MËKATIT BASHKËSHORTOR	18
TAKIMI I FUNDIT	28

PERSONAZHET

AI

AJO

VENDI I VEPRIMIT

Një dhomë e zakonshme në një shtëpi të zakonshme

KOHA

Në ditët tona

Historia e parë TË PASNESËRMEN

*(Një dhomë e zakonshme në një shtëpi të zakonshme. Një shtrat dopio dhe një telefon. Në dysheme dhe mbi karrige ka pako, veshje të ndryshme, kuti me sende të blera, etj.)
(Al dhe AJO janë shtrirë në shtrat.)*

AJO: *(Duke e puthur)* Je i lumtur me mua?

AL: Po.

AJO: Vërtet?

Po.

AJO: Edhe unë me ty. Vetëm se nuk më besohet kjo histori.

(Përsëri një puthje e gjatë. Bie telefoni. AJO e merr dhe e rimbyll pa e ndërprerë puthjen. Telefoni bie përsëri. AJO ia ngul sytë e acaruar.)

Më lodhi. Nuk pushoi asnjë sekondë sot. Ka ditë të tëra që nuk pushon.

AL: Hiqe kordonin fare.

AJO: Ti e di që s'mundem.

(Ngre receptorin.)

Po?...Moj mama, po ta thashë njëherë e mirë, asnjë mysafirë...Nuk dua dhe pikë. Më thuaj, kush po martohet, ti apo unë? *(E mbyll duke e hedhur receptorin.)* S'i duroj dot këto ceremoni idiote: dëshmitarë, taksitaxi, fotografë, shampanjë, unaza, shumë zhurmë për asgjë, apo jo?

AL: Ashtu është.

AJO: Dasma bëhet për ata që martohen, jo për dynjanë, apo jo?

AL: Ke të drejtë.

AJO: Por, me ç' duket, janë gjëra që nuk do t'u shpëtoj dot as unë.

AL: Në fund të fundit, mysafirët nuk janë gjëja kryesore...

AJO: Jo. *(E përqafton.)* Më do?

AL: Po.

AJO: Shumë?

AL: Shumë, shumë.

AJO: Dhe unë të dua shumë.

(Puthje e gjatë. Bie telefoni.)

AL: Ta marrë dreqi! Stakojë fare!

AJO: Sot jo. Ti e di që s'mundemi. *(Në telefon)* Alo! Po, teze...Jo, nuk kam kohë të endem nëpër dyqane.

Tani jo. Jam shumë e zënë. Kam për të bërë shumë gjëra. Të lutem, mos më bezdis më. *(Mbyll telefonin.)*

Afrohu!

AL: Në fillim stako telefonin!

AJO: Sot mos ma kërko. Ti e kupton. S'mbarojnë telefonatat.

Historia e parë. Të pasnesërme

AL: Prandaj duhet ta stakojmë.

AJO: *(Pas një hezitimi të shkurtër)* Mirë, pra, tërhiqe kordonin.

AL: Ke blerë shtrat të ri?

AJO: Tani e vure re?

AL: Jo, pse? Sapo hyra këtu.

AJO: E sollën sot në mëngjes. Nuk të pëlqen?

AL: Jo, pse? Alamet shtrati.

AJO: Ke një pamje të çuditëshme.

AL: Kjo është pamja ime normale.

AJO: I vjetri ishte shumë i ngushtë.

AL: E kuptoj.

AJO: Dhe ky është më i rehatshëm, apo jo?

AL: Po. Po të vjetrin ku e ke vendosur?

AJO: Është në dhomën e mamasë. Mjaft rrudhe vetullat. Tërhiqe kordonin dhe afrohu.

AL: Si është mamaja jote?

AJO: Shumë e bukur.

AL: Ti, i ngjan?

AJO: Oh, jo.

AL: Po edhe ti je shumë e bukur.

AJO: Vërtet?

AL: *(Duke e përqaftuar)* Je shumë seksi. Nuk më zuri gjumi gjithë natën. Imagjinoja sikur ne...*(Bie telefoni.)*

AJO: *(Duke psherëtirë)* A nuk të thashë ta stakojë kordonin?

AL: Mos e merr!

AJO: Hera e fundit. *(Në telefon)* Alo? Faleminderit! Oh, faleminderit...Po, fustani është gati. Faleminderit! *(E mbyll.)*. Këto ishin urime.

AL: Ma mori mendja. Me që ra fjala, nuk të kam parë me fustanin e nusërisë.

AJO: *(E gjallëruar)* Po të duash e provoj.

AL: Sigurisht. Edhe unazën.

AJO: Patjetër! *(Kërcen nga shtrati, vë unazën dhe i tregon dorën.)* Të pëlqen?

AL: Sikur të rri e madhe?

AJO: Kështu është moda.

AL: Epo mirë, ta gëzosh!

AJO: Nuk të pëlqen?

AL: Jo, kush tha? Sidoqoftë, nuk është unaza gjëja kryesore.

AJO: Dhe tani fustani. *(E merr me kujdes dhe e vesh.)* Si të duket?

AL: *(I impresionuar)* I mrekullueshëm!

AJO: Dhe nga prapa.

AL: I mrekullueshëm!

AJO: Oh, harrova këpucët. *(Vesh këpucët.)* Dhe tani, shiko!

AL: A mund të të marrë në krahë.

AJO: Jo, se zhubrosët.

Historia e parë. Të pasnesërme

AL: Do të të mbaj me shumë kujdes. *(E përqaqon.)*

AJO: Prit! Do ta heq. *(E heq fustanin dhe këpucët.)* Tani po, më përqafo!

AL: Hiqe dhe unazën!

(AJO e heq dhe unazën. AI e përqaqon me pasion. Bie telefoni.)

Ta marrë dreqi, ta marrë! Çfarë ka që nuk pushon?

AJO: Nuk e di...*(Buzëqesh.)* Ndoshta është xheloz. *(Në telefon)* Alo... Mama. Do të më dalë koha për t'i bërë të gjitha nëse ti nuk më ndërpret orë e çast. Nuk kam asnjë sekondë për të humbur. Jam e zënë me diçka shumë të rëndësishme dhe ti nuk më le rehat. *(E mbyll.)*

AL: Me që ra fjala, kur është ceremonia?

AJO: Nesër. Nuk e di?

AL: E di, por dua të them çfarë ore?

AJO: Në katër, pse?

AL: Jo, ashtu kot.

AJO: Duhet patjetër të bëj diçka. Kemi shumë pak kohë.

AL: Së pari, më jep diçka për të ngrënë.

AJO: Ke uri?

AL: Jo, po më pëlqen kur gatuan për mua.

AJO: *(E përkëdhelur)* Vërtet?

AL: Po.

AJO: Ulu.

(AI ulet në tryezë. AJO vesh me të shpejtë një përparëse dhe shtron tryezën. AI e kundron.)

Pse shikon ashtu?

AL: Po të admiroj...

AJO: Çfarë po admiron?

AL: Lëvizjet e tua janë delikate dhe të përpikta.

AJO: Lëri budallallëqet!

AL: Më jep kënaqësi kur të shikoj duke bërë diçka për mua.

AJO: Kurse mua më jep kënaqësi kur bëj diçka për ty.

AL: A mund të të puth?

AJO: Fillo të hash tani!

AL: A e di se cili është kulmi i kënaqësisë me ty?

AJO: Ai atje. *(Bën me kokë nga shtrati.)*

AL: Jo. Kur ti kujdesesh për mua. Megjithëse, edhe "atje".

AJO: Kurse unë kënaqem shumë kur shëtisim dhe ti fillon e tregon historira.

AL: Po atje? *(Tregon shtartin.)*

AJO: Sa për "atje", as nuk kam fjalë.

(Bie telefoni. AJO e merr.)

Alo? *(Ndryshon tonin e të folurit.)* Po, i dashur. Oh, jo, jo sot. Kam shumë punë...Jam...po vendos perdet e reja...Duhet edhe t'i ildis, t'iu kthej palën e fundit...Jam e zënë deri në grykë...Të puth fort!

(E vendos receptorin me ngadalë.)

AL: Besoj se nuk të bezdis prania ime, ë?

AJO: Jo.

Historia e parë. Të pasnesërme

AL: Po të duash, unë mund të kaloj nga dhoma tjetër.

AJO: Pse? Më mirë po stakoj telefonin.

(Stakon kordonin. Pastaj e shikon ATË duke ngrënë.)

Është e mirë?

AL: Oh, po.

AJO: Do më?

AL: Po, faleminderit.

(AJO vendos një pjatë tjetër në tryezë.)

AJO: Ndërkohë unë po mbaroj punë me perdet.

AL: Duhet patjetër?

AJO: Përndryshe, si do justifikohem se çfarë kam bërë gjithë ditën?

AL: Vërtet është punë që kërkon gjithë ditën të bëhet?

AJO: Jo, vetëm pesë minuta gjithsej. *(Fillon të ildis perdet.)* Unë punoj shumë shpejt. Si të duken perdet?

AL: I keni blerë bashkë?

AJO: Po.

AL: Të mira.

AJO: Shkojnë edhe me veshjen e murit.

AL: *(Duke parë murin)* Kjo nuk ishte dje.

AJO: E vendosëm mbrëmë. Të pëlqen?

AL: Mirë duket. Ai, këtu jeton?

AJO: Ende jo.

AL: Ti je grua që i respekton shumë rregullat. Apo e kam gabim?

AJO: Ti do doje që ai të jetonte këtu?

AL: Unë nuk dua asgjë. Po kjo këmishë e tij, ç' do këtu?

AJO: E bleva dje. Të pëlqen?

AL: S'është e keqe. Unë vetë do të preferoja një ngjyrë më të çelur.

AJO: I kam blerë edhe një tjetër, më të çelur. Në fakt, ka nevojë edhe për mbathje, po unë nuk marr vesh nga mbathjet e burrave! Po ti?

AL: Ja, ashtu...

AJO: A mund t'i blesh ti nja dy a tri palë, të jenë cilësi e mirë?

AL: Sigurisht, pse jo? Sa e ka numrin?

AJO: XL, besoj.

AL: Është i bëshëm, apo si?

AJO: Pak po. Po unë do ta detyroj të mbajë djetë. Do ta ushqej me zarzavate.

AL: Ti do të bëhesh një grua e dhimbsur.

AJO: Ka ndonjë gjë të keqe?

AL: Jo, përkundrazi.

AJO: Ha!

AL: Po ha. E ke gatuar për atë, ë?

AJO: Jo, për ty.

AL: Pra, mund ta ha të gjithë?

AJO: Po.

AL: Po për atë, çfarë ke gatuar?

AJO: Për atë do të filloj të gatuaj pasnesër.

AL: Po nesër, çfarë do të bësh?

AJO: Ha!

AL: Po ha.

(Pauzë)

AJO: Shtrati nuk më duket i fiksuar mirë. A ke mundësi t'ia shtrëngosh pak këmbët?

AL: Po mundohem njëherë. Më sill një kaçavidë dhe një çekiç.

AJO: Mbaro njëherë së ngrëni.

AL: Kam mbaruar. Ishte shumë e shijshme.

AJO: Do çaj?

AL: Pasi të kem mbaruar punë me krevatin.

AJO: Unë ndërkohë po ziej ujin për çaj.

(AJO i sjell veglat, del për në kuzhinë dhe kthehet për të rimarrë qepjen e perdes.)

Hë, si po shkon?

AL: Po e mbaroj.

AJO: Kaq shpejt?

AL: Po...Tani nuk lëvizin më.

(AJO shkon tek shtrati dhe e provon.)

AJO: Shumë mirë. Je i madh.

AL: *(Përpiqet ta përqafojë.)* Duhet ta provojmë.

AJO: Jo. Nuk kemi kohë. Kemi për të varur perdet.

AL: Epo, mirë. Por pas çajit.

AJO: Ja, tani vjen çaji.

(AJO sjell çajin, e hedh në filxhan dhe i afron atij një pjatë me kek.)

AL: Ç'është kjo?

AJO: Kek me mollë.

AL: E ke bërë vetë?

AJO: Për ty. *(AI e shijon.)* Të pëlqen?

AL: *(Duke e shijuar)* Ëhmm, i shijshëm, shumë i shijshëm.

AJO: Vërtet?

AL: E them me gjithë mend. Ke duar të arta. Më luajnë mendsh duart e tua!

AJO: Vetëm ato?

AL: Dhe gjithçka tjetër jotja!

AJO: Merre kekun me vete. Po e paketoj.

AL: Oh, jo.

AJO: Pse kështu?

AL: S'mund ta çoj në shtëpi.

AJO: E kuptoj. Po të jap recetën, atëhere.

AL: Për çfarë?

AJO: Për bashkëshorten tënde.

AL: Asaj nuk i pëlqen të gatuajë në furrë.

AJO: Sa keq.

AL: Shumë keq.

AJO: *(Duke i dhënë perden)* Mbaje këtu, në anë.

(ATA hipin në karrike dhe fillojnë të rregullojnë perden.)

AL: Po me mbathjet, si t'ia bëjmë, do t'i blejmë bashkë apo të shkoj vetëm?

AJO: Mbase shkojmë bashkë.

AL: Shumë mirë. Ti, të më ndihmosh të blej një çantë për gruan.

AJO: Ka nevojë për çantë?

AL: Më duhet t'i bëj një dhuratë.

AJO: Me ç'rast?

AL: Ka ditëlindjen.

AJO: Atëhere është mirë t'i blesh një palë këpucë. Ç'numër ka?

AL: S'e di. Më duket se 37.

AJO: Paskemi të njejtin numër. Çfarë modeli i pëlqen?

AL: S'e kam idenë.

AJO: Po ngjyra?

AL: S'e kam idenë.

AJO: Pa merak. Do blej ato që më pëlqejnë mua.

AL: Rrofsh!

AJO: Është e bukur?

AL: Po.

AJO: Po e zgjuar?

AL: Po.

AJO: Dhe ti e do.

AL: Jo.

AJO: Pse?

AL: Histori e gjatë.

AJO: Po mua?

AL: Ty, të dua.

AJO: Më do shumë, shumë?

AL: Shumë, shumë.

AJO: Pse?

AL: Nuk e di.

AJO: S'më kënaq kjo përgjigje.

AL: Po është e singertë.

AJO: Mund të zbresësh nga karrikja tani? Mbaruam.

(Tërheq perden dhe e shikon me mëdyshje.)

Si të duket?

AL: Shumë e bukur.

AJO: Po dizenjua?

AL: E përsosur.

AJO: Është vërtet e përsosur, po ti nuk e vë re.

AL: Pse?

AJO: Sepse dizenjua është nga ana tjetër. E kam varur mbrapsht.

AL: Pse?

AJO: S'e di.

AL: Do ta heqim dhe do ta varim përsëri?

AJO: Duhet patjetër. U mërzite?

AL: Oh, jo. Nuk ka problem.

(E vendosin perden ashtu siç duhet.)

AJO: Tani po. Nuk është e bukur?

AL: Po.

AJO: *(Duke e puthur)* Faleminderit, shpirt!

AL: S'ka gjë. Sa kohë keni që njiheni?

AJO: Dy vjet. Kisha nevojë për ndihmën tënde. Faleminderit!

AL: S'ka gjë. Nuk e kuptoj se si duron ai larg teje për një kohë kaq të gjatë?

AJO: Pse, është e vështirë?

AL: Unë nuk do duroja dot asnjë ditë të vetme.

AJO: Kështu të duket se kemi vetëm një javë që njihemi. Pas dy vjetësh do t'ia dilje që ç'ke me të, larg meje.

AL: S'është e vërtetë.

AJO: Për të qenë e sinqertë, nuk do të vija bast për këtë.

AL: Ndoshta tani nuk të intereson të vësh bast?

AJO: Nuk e di.

AL: Të mrekullueshme perdet!

AJO: E the njëherë këtë.

AL: E ke shumë të lezetshme dhomën e gjumit. Po ai frigorifor, ç'do aty?

AJO: Dhuratë për martesë.

AL: Pse nuk është në kuzhinë?

AJO: Nuk ka vend. Atje është frigoriferi i mamasë.

AL: Po në këto kuti, çfarë ka? Dhurata, edhe aty?

AJO: Po. Ka ndonjë gjë të keqe?

AL: Jo, asgjë të keqe.

AJO: Ke marr një pamje të çuditëshme.

AL: Kjo është pamja ime normale.

AJO: Ke qejf t'i shikosh dhuratat?

AL: Sigurisht, po.

AJO: Epo mirë, atëhere....Kjo këtu besoj se është me filxhanë. *(E hap kutinë.)* Po, filxhanë çaji. *(Nxjerr një filxhan me pjatën e vet.)* Ja, shikoje.

AL: Jashtë mase i bukur! Me që ra fjala, gjithmonë harroj të pyes, përse po martohesh me të?

AJO: Edhe në këtë kuti ka porcelan, por kjo është me pjata. Ja shikoji.

AL: Shumë të bukura.

AJO: Janë angleze. Pse, nuk e di ti pse martohet gruaja?

AL: Besoj nga dashuria.

AJO: Ti, u martove me dashuri?

AL: Po.

AJO: E çfarë ndodhi pastaj?

AL: Pjata fantastike. Po kutia tjetër, çfarë ka?

AJO: Një kukull.

AL: Dhuratë e çuditshme martese.

AJO: Është kukull e famshme. *(E nxjerr nga kutia.)*

AL: Hë pra, më thuaj, pse martohet gruaja?

AJO: Për të pasur një burrë dhe fëmijë. Shiko, ç'kukull!

AL: Tepër e lezetshme. Ti, do që të kesh fëmijë?

AJO: Sigurisht që dua.

AL: Në përgjithësi apo vetëm me të?

AJO: Hap e mbyll sytë dhe thotë "Mami, mami". *(E shtrëngon kukullën në gjoks.)*

AL: Kukull e bukur. Të pyeta, në përgjithësi apo vetëm me të?

AJO: As ashtu, as kështu.

AL: Po si atëhere?

AJO: Pa vrite pak mendjen.

AL: *(I shtangur)* Ti je e çmendur.

AJO: Po, ashtu jam.

AL: Dhe është kjo arsyeja që të dua kaq shumë.

AJO: Edhe unë të dua. *(AJO vazhdon të shikojë kutitë dhe pakot.)* Ç'kemi tjetër? Këto besoj janë për kuzhinën. Thika, lugë, pirunj.

AL: Gjëra praktike. Do të them diçka shumë banale, por të vërtetë.

AJO: Ja dhe një përparëse.

(E tregon përparësen.)

AL: Gjë e lezetshme. Njëriu nuk duhet të martohet pa dashuri.

AJO: Pse pa dashuri? Ai më dashuron.

AL: Kjo nuk ka rëndësi.

AJO: Kjo është gjëja më e rëndësishme.

AL: Mos i beso një të huaji!

AJO: Pse i huaj? Ai për mua është shumë i dashur.

AL: Si vëlla.

AJO: Si burrë. Kemi dy vjet bashkë.

AL: Ti nuk ke për të qenë e lumtur me të.

AJO: Do të kisha qenë po të mos kisha takuar ty.

AL: Ti, e dashuron?

AJO: Ne i përshtatemi njeri-tjetrit.

AL: E dashuron?

AJO: Unë të dashuroj ty.

(Pauzë. AJO, pa ndonjë qëllim, por me kujdes, lëviz pakot nga një vend në një tjetër.)

AL: A ka mundësi të mos i luash kot më kot ato kuti?

AJO: Kutitë...? Oh, më fal!

(AJO i jep një pikturë që i gjendet në duar.)

AL: Dhuratë tjetër?

AJO: Po...Të lutem, vare në mur!

AL: Pra nesër, natën, ti do ta kalosh me të.

AJO: Po.

AL: Dhe gjithë netët e tjera.

AJO: Po.

AL: Është absurde dhe e neveritshme.

AJO: Çfarë propozon ti?

AL: Asgjë. *(Duke varur pikturën)* Shiko, është drejt?

AJO: *(Duke mos e parë pikturën)* Po. Mendo për një çast sikur unë të mos martohesha me të. Atëhere, çfarë do të ndodhte?

AL: Nuk e di.

AJO: Në fund të fundit, unë bëj çfarë të më thuash ti.

AL: Ti duhet ta vendosësh vetë.

AJO: Unë, për vete, e kam vendosur.

AL: Shumë bukur.

(Pauzë)

AJO: Pikturë e bukur, apo jo?

AL: Shumë interesante.

AJO: Hiqe, të lutem!

AL: Pse?

AJO: Sepse ashtu dua unë.

(Ai e heq pikturën.)

Tani hiq perdet.

AL: Pse?

AJO: Vazhdo dhe mos pyet, të lutem!

AL: Atëhere, pse i vendosëm?

AJO: Sepse harrova.

AL: Çfarë harrove?

AJO: Se dhoma nuk është për ne.

AL: Po për kë?

AJO: As për ty as për mua.

AL: Pse jo as për ty?

AJO: Mamaja nuk do që ne të banojmë këtu.

AL: Nuk e do mamaja atë, apo ai nuk e do mamanë?

AJO: E di, mamaja është shumë e mirë...

AL: Po ai?

AJO: Dhe ai është shumë i mirë.

AL: Veçse, këta njerëz të mirë nuk duan të jetojnë bashkë.

AJO: Po. Po çështja nuk qëndron këtu. Edhe unë dua apartamentin tim.

AL: Do që të kesh jetën tënde të pavarur?

AJO: Po . Ka ndonjë gjë të keqe?

AL: Asgjë të keqe.

AJO: A do të më ndihmosh të gjej një apartament?

AL: Sigurisht. Po pse nuk ja kërkon atij?

AJO: Sepse ai nuk është natyrë praktike.

AL: As unë.

AJO: Po refuzon.

AL: Jo.

AJO: Vjehrra jote, jeton me ty?

AL: Jo.

AJO: Shkoni mirë?

AL: Jo keq.

AJO: Po me gruan?

AL: Edhe me atë.

AJO: Jeton më vete, edhe nga ajo?

AL: Jo, bashkë.

AJO: Sa keq.

AL: Po, shumë keq.

(Pauzë. Të dy heqin perdet.)

AJO: U shëmtua dhoma menjëherë.

AL: Po.

AJO: Dhe ngjan si e parregulluar.

AL: Po.

AJO: *(E lodhur)* Duhet të vendos gjërat në vendin e tyre. Tani kthehet mamaja.

AL: Ashtu? Sa shpejt iku dita.

AJO: Të lutem, sistemoi ato kutitë atje.

AL: Po telefonin, pse e fsheh në frigorifer?

AJO: As vetë s'e di. Më fal.

AL: Me që ra fjala, u bë kohë që s'ka rënë. E ke vënë re?

AJO: Oh, harrova. Kam stakuar kordonin.

(AJO lidh kordonin dhe, menjëherë, bie telefoni. AJO i përgjigjet:)

Po, i dashur... Jo, ta thashë njëherë. Sot, mos eja.... Mos u mërzit, kemi një jetë të tërë përpara.....Oh, jo, mos shko te berberi, ai do të të katranos më keq...Epo mirë, eja sonte mbrëma, por s'do rrish gjatë. Do të qeth vetë. Mirupafshim, i dashur!

(E mbyll.)

AL: Do ta qethësh ti?

AJO: Po. Ka ndonjë gjë të keqe?

AL: Jo, asgjë të keqe.

AJO: Zemër, çfarë ke kështu?

AL: Asgjë.

AJO: Ke një ton të çuditshëm.

AL: Ky është toni im normal. Po dëgjoj se i thërret të gjithë me të njejtin emër.

AJO: S'është e vërtetë. Ai është "i dashur", kurse ti je "zemër".

AL: Është e njëjta gjë.

AJO: Ti s'kupton fare.

AL: Gjithmonë, kam menduar se është idiotësi të jesh xheloz për burrin ose për gruan.

AJO: Po tani, si mendon?

AL: Njësoj.

AJO: Pra, nuk je xheloz për mua?

AL: Jam. Por ai akoma nuk është burri yt.

AJO: Pra nesër, nuk do të jesh më xheloz?

AL: Çfarë ore shkon zakonisht në shtrat?

AJO: Zakonisht?! Ne nuk kemi shkuar akoma në shtrat.

AL: Po nesër?

AJO: *(Duke ngritur supet)* Rreth orës njëmbëdhjetë.

AL: Në njëmbëdhjetë e pesë do të telefonoj për një bisedë dy orëshe.

AJO: Faleminderit që ma the paraprakisht. Që të stakoj kordonin.

AL: Unë do t'i vë flakën shtëpisë.

AJO: Unë do të thërras zjarrfikësit.

AL: E kam seriozisht.

AJO: Edhe unë... Oh, kujdes. Se ka porcelan në atë kuti!

(Al e flak kutinë në dysHEME. Dëgjohet zhurma e porcelanit që thyhet.) Ç'pate?

AL: Mua më ka ardhur shpirti në majë të hundës dhe jam gati ta bëj gjithçka copa-copa, kurse ti më paralajmëron të kem kujdes, edhe pse e di shumë mirë se jam duke sistemuar folezën tënde të dashurisë. Ti je e pandjeshme. Nuk do të habitesha edhe sikur të më dërgoje që të blija për ty...

AJO: Çfarë?

AL: Asgjë. Nuk e duroj dot mendjehetësinë tënde, qethjen e tij nga ana jote, unazat e tua të martesës dhe kekun tënd.

AJO: E di, zemër.

AL: Mos më thuaj zemër!

AJO: Si të duash.

AL: Ti je një femër e ftohtë dhe e pashpirt!

AJO: E di.

AL: Dhe femrat e ftohta dhe të pashpirta, i urrej!

AJO: E di.

AL: Ti ke vetëm një synim në jetë: të mos mbetesh beqare.

AJO: Pse, ti do që unë të mbetem beqare?

AL: Unë nuk dua asgjë. Dhe më qesharakja është se ti je kaq e kënaqur me këtë martesë.

(AJO hesht.)

Mua përpiqesh të më ngopësh me lugë të zbrazët. Po unë nuk dua të ngopem me lugë të zbrazët!

(AJO hesht.)

Tët shoq ti e merr në shtëpi dhe e krasit si një livadh me bar, kurse mua...Çfarë dreqin ke që rri kështu e nuk flet asnjë fjalë?

AJO: E çfarë të them? Lëmshi ku jemi mpleksur nuk zgjidhet me fjalë.

Historia e parë. Të pasnesërme

AL: Ti mban të fshehur nën mëngë asin kundër meje. Pse nuk e luan?

AJO: Unë nuk luaj me ty.

AL: Thuaj se unë e kam tashmë familjen time dhe se ti nuk ke rrugëdalje.

AJO: E pse ta them?

AL: Thuaj se, përderisa ti fle me gruan tënde, unë do të fle më burrin tim.

AJO: E pse ta them?

AL: Më gric atje ku më dhemb!

AJO: Po unë nuk kam qëllim të të shkaktoj dhimbje.

AL: Pse nuk më kërkon që unë ta braktis familjen?

AJO: Ti do që unë të kërkoj një gjë të tillë?

AL: Unë nuk dua asgjë.

AJO: *(Me ngadalë)* Shumë keq nëse nuk do asgjë.

AL: Unë doja, po, doja shumë, natë e ditë shpresoja që ti të thoshe: “Nuk mundem më”. Që ti të thoshe: “Më mirë beqare përjetë”.

AJO: E pastaj, çfarë?

AL: Pastaj edhe unë do të braktisja gjithçka. Por për ty ishte më mirë një vezë sot se një pulë mot. Ti do që të jetosh me njërin, por ta kesh edhe tjetrin. Apo jo?

AJO: Po .

AL: Për një grua, unë do ta kisha braktisur familjen pa e vrarë mendjen, nëse për të unë do të isha burri i vetëm në botë. Kurse ti nuk arrin të shtysh as dasmën. Asnjë ditë të vetme.

AJO: Ti e di mirë që unë jam e gatshme ta braktis fare atë burrë.

AL: Po , do ta bëje menjëherë për një pazar më të mirë.

AJO: Shpirt, të lutem...

AL: Mos më thuaj “shpirt”

AJO: Pse?

AL: Sepse e përbuz këtë fjalë.

AJO: E di.

AL: E përbuz gjithçka tënden.

AJO: E di.

AL: Ti je një kurvë, një kurvë ordinere.

AJO: E di.

AL: Nuk më zinte gjumi mbrëmë – nga përbuzja.

AJO: E di.

AL: Jam i lumtur që arrita të njoh menjëherë se cila je.

AJO: Ti mendoje se unë isha heroinë, apo shenjtoje?

AL: Unë nuk mendoja asgjë.

(I drobitur siç është, Al bie menjëherë në heshtje. Pauzë)

AJO: Është e thjeshtë, çdo gjë. Një javë para martesë, mësova për herë të parë në jetë se ç’është dashuria dhe ç’është burri. Dhe ky burrë nuk ishte ai me të cilin isha fejuar. Dola fare nga mendtë. Dhe tani nuk di çfarë të bëj.

(Al hesht.)

Dhe sa kohë na mbetet bashkë, ne të dyve, ty dhe mua? Edhe ca ditë? Edhe ca minuta?

(Al hesht.)

Por unë e kam jetën përpara. Kam një jetë të tërë. Duhet ta mendoj mirë dhe ta menaxhoj ashtu siç duhet. Nëse nuk e bëj unë për vete, kush do ta bëj për mua?

(Al hesht.)

Janë blerë unazat, fustani është gati, janë shpërndarë ftesat, kanë ardhur mysafirët, farefisi...Unë për vete nuk e ndaloj dot...Por nuk e di, ti çfarë do? Të lutem, ma thuaj! *(Pauzë)* Pse nuk flet?

AL: Po mendoj sesa të lumtur mund të kishim qenë.

AJO: *(Hidhur)* Po .

AL: Dhe se si do ta shkatërrojmë gjithçka me duart tona...

AJO: Po .

AL: Të vjen keq që u takuam?

AJO: Jo. Po ty?

AL: Jo. Unë të dua shumë.

AJO: E di. *(Pauzë)* Mamaja mund të vija nga çasti në çast. Tani, duhet largohesh.

AL: Çfarë vendose?

AJO: *(E lodhur)* Asgjë

AL: *(Duke u çuar)* Pafshim!

AJO: Prit pak. Edhe pesë minuta.

(AJO e përqafton.)

Mos më mbaj mëri që të kërkova të më ndihmosh për perdet dhe pastaj...!

AL: Unë nuk të mbaj mëri për asgjë.

AJO: Më pëlqente që t'i bëja punët me ty.

AL: Edhe mua.

AJO: Gjatë tërë kohës imagjinoja sikur ajo që bënim ishte për ne: për mua dhe për ty.

AL: Nuk e kuptova. Më fal

AJO: Mirupafshim, shpirti im!

AL: Do të shihemi përsëri?

AJO: Mendon se ka kuptim?

AL: Jo.

AJO: Një herë e vetme nuk do të ndihmonte për asgjë dhe nuk do të zgjidhte asgjë.

AL: E di.

AJO: Atëhere, pse të takohemi përsëri?

AL: Ke të drejtë. Po unë nuk jetoj dot pa ty.

AJO: As unë.

AL: Pra, shihemi nesër?

AJO: Nesër, është e pamundur, mos e diskuto!

AL: Atëhere, pasnesër.

AJO: *(Pas një hezitimi të gjatë)* Mirë.

AL: Mendon se mundemi?

AJO: Do ta gjej unë zgjidhjen. Më do?

AL: Shumë, shumë, shumë.

AJO: Edhe unë të dua.

Historia e parë. Të pasnesërme

(Pauzë)

Çfarë po mendon?

AL: Shumë gjëra...

AJO: Kurse unë - unë po mendoj vetëm një gjë.

AL: Çfarë?

AJO: Të pasnesërmen!

FUNDI I HISTORISË “TË PASNESËRMEN”

Historia e dytë

LEZETET E MËKATIT BASHKËSHORTOR

(Një burrë ecën lartë e poshtë në dhomë, me nervozizëm, duke parë orën e dorës . Duket qartë, Ai është duke pritur me padurim dikë. Zhurmë e derës që hapet. Një grua hyn vetëtimthi brenda. AJO ka të veshur një pallto. Në dorë ka një çantë të madhe psonisje. Ai, i lodhur nga ankthi i pritjes, por edhe i lumtur, i hidhet për ta përqaftuar.)

AL: Më në fund!

(Një puthje e gjatë)

Pothuajse e kisha humbur shpresën

AJO: Edhe unë. E pata shumë të vështirë të ikja pa u vënë re.

AL: Pse po dihat?

AJO: Duke vrapuar gjithë ditën. Ti e di, kemi shumë pak kohë.

(AJO tenton ta përqaftojë.)

AL: *(Duke iu shmangur)* E ke mbyllur derën me kyç?

AJO: Oh, jo. Harrova.

(AJO tenton ta përqaftojë.)

AL: *(Duke iu shmangur)* Prit! Të mbyllim derën njëherë.

(Kyç derën, e verifikon përsëri me kujdes, kthehet dhe tenton ta përqaftojë.)

AJO: *(Duke iu shmangur)* Prit. Takova një burrë në shkallë. Më pa në një mënyrë...Sikur më ra pika.

AL: *(Me ankth)* Çfarë tipi ishte? Mos ishte një plak me bastun, me pizhama?

AJO: Jo, pa bastun, me pulovër.

AL: Të pa që u fute këtu?

AJO: Jo. Bëra sikur u ngjita në katin sipër.

AL: *(I qetësuar)* Atëhere, nuk duhet të kesh frikë.

(AI tenton ta përqaftojë.)

AJO: *(Duke iu shmangur)* Po mua m'u duk sikur më njihte...

AL: Pse t'u duk ashtu?

AJO: Burri im më tha se një kolegu i tij jeton diku në këtë lagje.

AL: Në këtë lagje jetojnë njëqind mijë banorë.

AJO: Dhe gjithkush mund të më njohë.

AL: E njeh nga pamja këtë kolegun e burrit?

AJO: Po .

AL: Ishte ai?

AJO: Jo.

AJO: E pse ke frikë atëhere, dreqi ta hajë?

AJO: Po sikur të ketë qenë një koleg tjetër? Që më njeh mua dhe unë nuk e njoh?

AJO: I bie që të kesh frikë nga çdo burrë që kalon në rrugë. Dhe nga çdo grua.

AJO: Po . Kam frikë.

AJO: Në fund të fundit, nuk është krim të ngjitësh shkallët e vetme.

AJO: Ti e ke të lehtë të flasësh.

AJO: Edhe sikur, mund të thuash që ishe te rrobaqepësi.

AJO: Po , po. Do ta gjej një justifikim.

AJO: *(Duke e tërhequr pranë vetes)* U qetësove?

(Puthje e gjatë)

AJO: *(Duke u tërhequr papritur)* Oh, çfarë bën kështu?

AL: Si është puna?

AJO: Jemi para dritares.

AL: Bie nga ana e lumit dhe jemi në katin e 35-të.

AJO: S'ka rëndësi. Kam një parandjenjë se të gjithë po na ruajnë ne.

(Al mbyll perdet, e tërheq pranë vetes dhe e përqaqon.)

AL: Ke ndonjë parandjenjë tjetër tani?

AJO: Jo.

AL: *(Duke u larguar një çast)* Mbase do ta heqësh më në fund këtë pallto?

AJO: Jo, i dashur, kam ardhur vetëm për një minutë.

AL: *(Nervoz)* Pse vetëm për një minutë? Ne e lamë që do të rrimë një orë të tërë.

AJO: Kanë ndryshuar rrethanat.

AL: Prapë? Po e kam pritur kaq shumë këtë takim!

AJO: Edhe unë.

(Al e përqaqon. AJO i përgjigjet përqaqimit por papritur e shtyn.)

E ke blerë mishin?

AL: Po .

AJO: Po qumështin?

AL: Sigurisht.

AJO: *(E qetësuar)* Kurse unë kisha frikë se mos kishe harruar.

AL: Jo, nuk harrova. Meqë ra fjala, t'i vendosim gjërat në çantë që tani. Përndryshe mund t'i harrojmë.

(Al nxjerr nga frigoriferi një copë mishi dhe disa shishe me qumësht.)

AJO: Sa bëri mishi? Domethënë, në rast se më pyet vjehrra.

AL: Njëzet e tre e dyzet.

AJO: *(Duke i dhënë paratë)* Faleminderit.

AL: *(Duke i kthyer kusurin)* S'ka përse.

(AJO e mbush çantën me ushqimet.)

AL: Sidoqoftë, ndoshta mund ta heqësh pallton?

AJO: Jo, i dashur. Ta thashë, kam ardhur vetëm për një minutë.

AL: Kur do ikësh?

AJO: Ja, ta llogarisim bashkë: ta zemë se jam duke blerë mishin dhe qumështin.

AL: *(I gjallëruar)* Duhet një orë.

AJO: Po . Por, po të heqim kohën që më duhet të vij këtu e të kthehem – nuk mbetet asgjë.

AL: *(I acaruar)* Nuk e kuptoj pse nxiton kaq shumë.

AJO: Kam për të gatuar.

AL: Po ty të ka gatuar gjithmonë vjehrra.

AJO: Kurse tani gatuaj vetë.

AL: Pse?

AJO: Që im shoq të mos e pikasë se unë nuk po e trajtoj ashtu si më parë.

AL: Më duket se ti ke marrë një ditë pushim që të më takosh mua dhe jo të gatuash për tët shoq.

AJO: Ashtu është, por vjehrrës sime nuk i pëlqen që unë të dal për shumë kohë. Ajo është natyrë shumë dyshuese.

AL: Po burri?

AJO: Edhe ai. Dje, kisha marrë çantën për të bërë pazar. Ai më pa, qeshi dhe pyeti: "Po del për të bërë pazar, ë?". Për pak sa nuk më pushoi zemra.

AL: Po në fakt, ti ku po shkoje?

AJO: Për të bërë pazar, ku tjetër? *(Merr çantën.)* Nejse, tani duhet të nxitoj.

AL: Po mund të gatuash në mbrëmje!

AJO: Në mbrëmje shkoj me burrin për të parë një ndeshje futbolli.

AL: Për të parë futboll?! Ti? E pse?

AJO: Që ai të mos pikasë asgjë.

AL: Më mirë të bësh sikur shkon për vizitë te Natalia.

AJO: Tani nuk shkoj më për vizitë te shoqet.

AL: Pse?

AJO: Që ai të mos pikasë asgjë. Në të vërtetë, tani bëj të pamundurën që as të mos i acaroj marrëdhëniet me të.

AL: *(Duke mos e parë drejtpërdrejt)* Çfarë bën tjetër ti që ai të mos pikasë asgjë?

AJO: Ti po bëhesh xheloz tani, apo si?

AL: Jo. Vetëm se u lodha së dërdëllituri për burrin tënd.

AJO: Mund të hapësh një temë tjetër.

AL: Çfarë, për shembull?

AJO: Dikur flisnim për muzikën, poezinë...

AL: Me që ra fjala, kam arritur të blej një libër të rrallë me poezi të vjetra për ty.

AJO: Ah, ashtu? Faleminderit!

(E merr librin me shumë qejf, por pastaj heziton.)

Jo, s'mund ta marr.

(Ia kthen.)

Ai do të më pyesë se ku e kam blerë.

AL: Mund t'i thuash se ma ka bërë dhuratë Natalia.

AJO: Ajo mund të llapë.

AL: *(Duke e flakur librin)* Epo mirë, pra, u kënaqëm duke folur për poezinë!

AJO: Mos u bëj nervoz!

AL: Nuk jam nervoz. Por vuaj kur mendoj se nuk lexojmë asgjë bashkë, kurrë nuk dalim bashkë...

AJO: Ti kujton se unë nuk vuaj? *(Pasi është menduar një çast.)* Kam një ide: të shkojmë në kinema.

Bashkë.

AL: Kur? Dhe si?

AJO: Është fare e thjeshtë. Presim biletë për të njëjtën shfaqje dhe sigurisht në vende të ndryshme. Unë të shkoj me burrin dhe ti, - me gruan. Dhe të imagjinojmë se po e shohim filmin bashkë. Mirë?

AL: *(Duke psherëtirë)* Mirë.

AJO: Më përqafo!

AL: Po si fillim duhet të heqësh këtë pallto të mallkuar

AJO: Po vetëm një minutë kohë kam.

AL: Nuk dua të përqafoj vetëm një minutë. Dhe me pallto. Se nuk u kam lënë zyrën një ditë të tërë për kaq pak.

AJO: *(I shkrep në kokë.)* Dëgjo! A ke ndonjë kokërr lakër?

AL: Lakër? Nuk e di. Mund të jetë një kokërr. Pse?

AJO: Po ta ma japash, unë mund t'i them vjehrrës se shkova në një dyqan tjetër për të blerë edhe një kokërr lakër. Nga kjo mund të fitojmë shumë kohë, - pesëmbëdhjetë, njëzet minuta. Ide interesante, apo jo?

AL: Fantastike!

(Merr një kokërr lakër dhe ja jep asaj. AJO e vendos në çantë. Papritur ndryshon AI mendje.)

Jo, nuk ta jap dot.

(Mundohet të nxjerr lakrën nga çanta e saj.)

AJO: Pse?

AL: E çfarë t'i them gruas? Unë nuk kam qenë në shtëpi, por kokrra e lakrës u zhduk!? *(E vendos lakrën në frigorifer.)*

AJO: Mirë, atëhere, do të them në shtëpi se mishi i dyqanit tonë nuk ishte i mirë, prandaj shkova tek një dyqan tjetër. Në këtë mënyrë fitojmë të njëjtin njëzet minutësh.

AL: *(I entuziazmuar)* Tani po flet me mend!

(Përqafohen, puthen.)

AJO: *(Me një psherëtimë të aposionuar)* Borja, i dashur!...

AL: *(I nervozuar)* Nuk jam Borja, jam Tolja.

AJO: E di. Po e kam më për mbarë të të thërras Borja.

AL: Pse?

AJO: Kam tmerrësisht frikë se mos më rrëshket gjuha dhe i thërras atij Tolja. Do të bëhej name!

AL: Ti je shumë nervoze.

AJO: Dhe, po të jesh edhe ti Borja, nuk do ju ngatërroj. Dakord?

AL: Epo...po të duash ti...

AJO: Faleminderit, Tolja.

AL: *(Me theks të veçantë)* Borja!

AJO: Oh, po, sigurisht. Borja. Të mbetet qejfi?

AL: *(Thatë)* Jo.

AJO: Atëhere, më parqafo fort!

(AI e përqafon. Me sy të mbyllur, AJO pëshpërit:)

Borja, i ëmbli im Beri, i shtrenjti im Beriberi...

AL: *(Duke u shkëputur nga AJO)* Kë po mendon, mua apo atë?

AJO: *(Duke hapur sytë)* Ty, sigurisht. Vetëm se po bëj prova që të mësohem me emrin tënd të ri.

AL: E kam të vështirë ta besoj.

AJO: Mos u bëj xheloz. Tani ndihem mirë, - kjo ka rëndësi.

AL: Ndërsa unë nuk ndihem mirë.

AJO: Pse?

AL: Sepse unë dua të përqafoj ty dhe jo pallton tënde.

AJO: Oh, e shkreta unë! Pse nuk më the që në fillim? Më kishte dalë fare nga mendja. *(E flak tej pallton.)*

AL: *(Duke e përqaftuar)* Më në fund!

AJO: *(Me pasion)* Borja, i dashuri im! I ëmbli im!

AL: Mos thërrit fort! Fqinjët poshtë i dëgjojnë të gjitha.

AJO: *(Me psherëtim)* Mirë. Nuk do të flas fare. *(Mezi dëgjohet.)* Më dashuron?

AL: Çfarë?

AJO: Po të pyes, a më dashuron?

AL: Ah... Po .

(Përqaftimet e tyre, që filluan me aq vështrësi, ndërpriten nga një tingull i mprehtë zileje telefoni.)

AJO: O Zot!

(Telefoni vazhdon të bjerë.)

AL: Të marrtë dreqi!

(Zilja përsëritet.)

T'i përgjigjem apo mos t'i përgjigjem? Kjo është çështja. Si do ishte më mirë...?

AJO: Të mos i përgjigjesh. Po sikur të jetë gruaja jote?

AL: Po ...*(Bëhet gati ta puth, por ndërron mendje.)* Puna është se unë u kam thënë çunave në zyrë se, po ta merrte vesh shefi mungesën time, të më telefonin.

(Tenton të marrë telefonin.)

AJO: Po sikur të jetë ajo?

(Të dy, ia kanë ngulur sytë telefonit si preja bishës. Telefoni pushon.)

AL: Pushoi. *(Fshin djersët nga balli dhe mban zemrën me dorë.)*

AJO: Faleminderit, Zot! *(E përqafton dhe e puth përsëri.)*

AL: Jo, nuk ishte ime shoqe.

AJO: Kështu mendon?

AL: Po . Ajo është e sigurt që unë nuk jam në shtëpi.

AJO: Ndoshta ka telefonuar në fillim zyrën tënde?

AL: Do t'i thoshin se unë kisha dalë vetëm për një minutë.

AJO: *(Duke e përqaftuar)* Hiqe tani mendjen që andej!

AL: *(Duke mos ia vënë veshin.)* Kush mund të ketë qenë?

AJO: *(Me padurim)* Më përqafo!

AL: Prit një minutë! *(Formon një numur në telefon.)* Toni? Jam unë. Është çdo gjë në rregull? Më telefonove ti pak më parë? Mirë, shihemi!

(E mbyll telefonin dhe shikon i habitur se AJO është veshur përsëri.)

Ç'ka ndodhur? Ku po shkon kështu?

AJO: Vajti ora, i dashur.

AL: Prit edhe pak!

AJO: S'mundem.

AL: Po ne nuk e kemi fiksuar akoma se kur do të takohemi herës tjetër!

AJO: Nesër unë nuk mundem. As pasnesër.

AL: Ndoshta të martën pas pune?

AJO: Pas pune unë marr vajzën nga dadoja. Më mirë të takohemi të premten.

AL: Të premten s'mundem unë. Na kanë ftuar në një drekë. Si thua për të djelën.

AJO: Fundjavat unë i kaloj në shtëpi tani.

AL: Që të mos pikasë burri asgjë.

AJO: Nuk kam nerva për humor.

AL: As unë.

AJO: Për mua do të ishte më e volitëshme java tjetër.

AL: *(Duke parë kalendarin)* Kam frikë se javës tjetër do të jem i mbytur me punë zyre.

AJO: Për sa kohë?

AL: Deri në fund të muajit.

AJO: Dhe muajin tjetër do të jem unë e zënë me provimet e kursit të rrobaqepësisë. Ndoshta, më vonë...

AL: Më vonë, unë largohem për një udhëtim pune.

AJO: Për sa kohë?

AL: Oh, nuk e di. *(Pas një pauze.)* Të përpiqemi se ndoshta takohemi të hënën?

AJO: *(Duke parë kalendarin)* Cilën të hënë? Të hënën tjetër?

AL: Jo. Të hënën pas të hënës tjetër.

AJO: Nuk mund të them dot tani për tani.

AL: Të lutem, le të takohemi! Qoftë edhe për gjysëm ore.

AJO: Mirë. Do përpiqem. Ku?

AL: Për mua do të ishte më mirë të takohemi në supermarket.

AJO: Jo. Ka shumë njerëz.

AL: Në bibliotekë, atëhere.

AJO: Është shumë e zbratur. Do të na vinin re menjëherë.

AL: Ndoshta në park?

AJO: Është shumë larg dhe ne kemi kaq pak kohë. Pastaj, atje është ftohtë.

AL: Atëhere takohemi në autobuzin e unazës dhe bëjmë një xhiro rreth e rrotull.

AJO: Që të na shohë i gjithë qyteti?

AL: Po mirë, ti, çfarë propozon?

AJO: *(Pasi mendohet një çast.)* Dakord, takohemi në autobus. Por ti do ta kesh shikimin, jo nga ana ime, por nga ana e kundërt. Nuk do të më flasësh dhe nuk do të ulesh në asnjë mënyrë pranë meje.

AL: Në rregull.

AJO: *(Duke mbajtur shënim në kalendar.)* Pra, muajin tjetër, data pesë, në orën gjashtë, në autobuzin numër 7.

AL: *(Duke mbajtur shënim në kalendarin e tij.)* Pesë...gjashtë...shtatë. Oh, prit! Këtë ditë, s'mundem.

AJO: Po ti vetë e caktove.

AL: Harrova fare se ime shoqe ka datëlindjen atë të hënë.

AJO: Po ti festove një ditëlindje muajin që shkoi.

AL: Jo, festova ditëlindjen e djalit, jo të sajën.

AJO: Ti, çdo javë, ke festa familjare.

AL: Jo çdo javë.

AJO: Nuk gjen dot një justifikim të largohesh vetëm një gjysëm ore?

AL: *(Duke vrrarë mendjen.)* Mos rastësisht të qëllon të qethësh ndokënd?

AJO: Jo.

AL: Sa keq. Mund t'u thosha se do shkoj te berberi.

AJO: Ta zëmë se di: po ku mund të qeth? Në park? Në autobus?

AL: Mos u acar.

AJO: Nuk po acarohem.

AL: Mirë, do të telefonoj më vonë.

AJO: Ti e di shumë mirë se nuk mund të më telefonosh.

AL: Dua të them, do të telefonoj në punë.

AJO: Mos u çmende? E merr vesh e gjithë zyra se më telefonon një burrë.

AL: E pastaj?

AJO: Ia raportojnë atij.

AL: Si?

AJO: Sikur nuk i njeh njerëzit ti!

AL: Po deshe, unë mund të të flas në telefon me zë gruaje.

AJO: Tolja, unë mendoj se...

AL: *(Me një theks të veçantë)* Borja!

AJO: Oh, po...Ke të drejtë. Borja. Më fal! E shikon sa lehtë shket gjuha.

AL: Çfarë po thoshe?

AJO: Që nuk flet dot si grua.

AL: Po ta kërkoj nevoja, edhe do ta bëj. *(Me zë gruaje)* "Mirëmëngjes! A ka mundësi të flas pak me...". Si t'u duk?

AJO: *(Duke psherëtirë)* Më mirë të të telefonoj unë ty. Në zyrë. Por, që të jem e sinqertë, e kam shumë të vështirë të të marr në telefon.

AL: Më e vështirë është të më gjesh mua në zyrë.

AJO: Po sikur të lë një mesazh?

AL: Interesante! Vetëm se do të ishte më mirë që mesazhi të kishte lidhje me punën.

AJO: E kuptoj. Për të qenë brenda, e ndryshojmë kohën dhe e vemë një ditë e dy orë prapa.

AL: Kam frikë se nuk po të kuptoj.

AJO: Pra, nëse unë them " Ju lutem, i thoni se konferenca është nesër në tre", në realitet, ne takohemi të pasnesërmen në pesë.

AL: *(Duke u përpjekur të kuptojë.)* Nesër në pesë...Në tre...Pasnesër...Unë mendoj se do të ishte më mirë të të çoja unë një mesazh me e-mail.

AJO: Jo. E shikon burri në kompjuter.

AL: *(Duke parë orën e dorës.)* Më fal po mua më vajti shumë vonë për në punë.

AJO: Po ne ende nuk e kemi caktuar takimin.

AL: Po marr në zyrë atëhere, që të sigurohem.

(Merr një numër dhe flet me zë gruaje:)

Mirëmëngjes! A ka mundësi të flas pak me Tonin, ju lutem? ... Toni? Hë, si po shkon?... Nuk po më njeh? *(Kujtohet, me zë normal)* Më fal, jam Borja! Cili Borja?... Dreq! Doja të thosha "Tolja". Jo, nuk kam pirë

dhe as po tallem. Ta shpjegoj më vonë...Si???? Kam marrë mungesë!!!...Urgjentisht?! Po shefi?...Është tërbuar?Ashtu?!...Po vij me vrap. Menjëherë. *(E mbyll.)* Oh. Zot!

AJO: Çfarë ka ndodhur?

AL: Do më pushojnë nga puna se kam munguar.

AJO: Oh, mos u mërzit, do gjendet një zgjidhje.

AL: Ti e ke të lehtë ta thuash.

AJO: Mos krijo panik!

AL: Shefi, u bë kohë që më është qepur. Vetëm një pretext do që të më flakë në rrugë.

AJO: Tani unë duhet të iki në shtëpi.

AL: Do dalim bashkë.

AJO: Në asnjë mënyrë. Mund të na pikasin.

AL: Ke të drejtë. Ik ti e para.

AJO: *(Duke marrë çantën)* Më puth para se të ndahemi.

AL: *(Duke e puthur me të shpejtë)* Pafshim!

AJO: Nuk është hiç e lehtë e gjithë kjo histori, apo jo?

AL: *(Duke veshur pallton)* Por jo aq e vështirë sa të mos rikthehesh.

AJO: Takimet me ty janë i vetmi gëzim i jetës sime. Po për ty?

AL: Edhe për mua.

AJO: A më do?

AL: *(Me padurim)* Të dua. Të dua. Ik, tani! Mirupafshim!

(AJO i afrohet daljes. Bie zilja e derës. ATA ndalen si të paralizuar.)

AJO: *(Me pëshpërimë)* Kush do të jetë?

AL: Ku ta dij unë?

AJO: Unë po...dr...po dri...po dridhem...nga...nga...

AL: Mos u tr...tr...trë...trëmb. Do t'i bien e do t'i bien dhe do të ikin.

(Zilja insiston.)

AJO: Po çmendem nga frika.

AL: Mbylle gojën! *(I zverdhur)* Më duket se po përpiqen të hapin derën. E dëgjon?

(Heshtje e tensionuar)

AJO: Shko pa zhurmë të shohësh nga vrima e çelësit!

(Al rrëshket në majë të gishtave drejt derës dhe, pasi ka parë, kthehet totalisht i çmeritur në pamje.)

AL: *(I pa shpresë)* Është gruaja.

AJO: *(Duke u dridhur)* Je i sigurt?

AL: *(Duke mbledhur supet)* Në sheshpushim është errësirë.

AJO: Ky është një makth i vërtetë. *(E tmerruar)* Bën vaki të hyjë?

AL: Jo. E kam mbyllur derën nga brenda.

(Zilja)

AJO: Oh, nuk duroj dot më.

AL: Mbaje veten! Duhet të presim pak.

AJO: Unë nuk pres dot. Duhet të jem në shtëpi urgjentisht.

AL: Edhe unë duhet të jem në zyrë.

AJO: Im shoq do të më vrasë!

AL: Shefi do të më flakë në rrugë!

AJO: Ajo duhej të ishte në punë. Pse ka ardhur kaq shpejtë?

AL: Nuk e di. Mund të jetë sëmurë. Ose mund të ketë harruar diçka.

AJO: Unë do kisha ikur me kohë, po ti me ato, "prit", "prit"-et e tua..

AL: Isha unë që të nxitova, po ty papritur t'u shkrep në kokë që të cicëroje.

AJO: Ti nuk je në vete. Po ta them copë, unë nuk doja fare të vija. Kisha parandjenjë të keqe.

AL: Dhe ti mendon se unë kisha qejf të ikja nga zyra duke e ditur se shefi mund të më pushonte nga momenti në moment? E dija që asgjë e mirë nuk do të dilte nga kjo punë.

(Zilja)

AJO: Duhet ta hapim. Në fund të fundit, ne jemi të veshur me pallto.

AL: Duhej ta kishim bërë sapo ra zilja. Çfarë do t'i themi tani?

AJO: Sido që të vejë, ne nuk kemi ku të mbytemi. Pse ta zgjatim?

AL: Ndoshta, pas gjithë kësaj pritje, mund të largohet.

AJO: Ti duhet ta kuptosh, unë nuk mund të pres më. *(Nervoze)* Ndoshta tani vjehrra po telefonon burrin...

AL: Pesë vjet! Pesë vjet m'u desh të bëja të pamundurën të arrija në këtë pozitë ku jam sot, - dhe e humbas brenda një dite si idiot.

AJO: *(Me vendosmëri)* Hape derën! Në fund të fundit, je burrë apo jo?

AL: Jam burrë! Po nuk e hap!

AJO: Nga se ke frikë? Ti më ke thënë me mijëra herë se midis teja dhe asaj çdo gjë ka marrë fund.

AL: Edhe ti më ke thënë sa e sa herë se ti dhe yt shoq jeni të huaj për njeri-tjetrin, e megjithatë, ti dridhesh para tij si gjethe plepi.

AJO: Kjo është komplet tjetër gjë.

AL: Edhe me mua është tjetër gjë. Si do ta shoh në sy tani?

AJO: Oh, po të vret ndërgjegja? *(Qesh.)* A nuk është pak vonë tani?

AL: Mua gjithmonë më ka vrarë ndërgjegja. Unë nuk jam si ti.

AJO: Nëse ti ke kaq frikë, unë po e hap derën vetë.

(Shkon me vendosmëri tek dera.)

AL: *(Duke e mbajtur me forcë)* Mjaft!

AJO: Frikacak, frikacak i mjerë!

AL: Në këtë çast ndoshta ëshë duke u rënuar gjithë jeta ime dhe ti ke merak se mos vonohesh për të shkuar te vjehrra jote e roitur.

AJO: Dhe ti dridhesh para një plake shëmtaraqe me të cilën duhej të ishe divorcuar njëqind e ca vjet më parë.

AL: Kjo "plakë shëmtaraqe" është, së pari, pesë vjet me e re se ty dhe, së dyti, njëzet herë më e bukur se ty. Krahasuar me të, ti ngjan si një kërpudhë e vyshkur.

AJO: Ashtu?! Përse bën dashuri me mua atëhere?

AL: Së pari, për variacion dhe, së dyti, nga budallallëku.

AJO: Sikur ta dije sa shumë të urrej tani!

AL: Unë të urrej edhe më shumë! *(Pauzë)*

E di, u bë kohë që nuk ka zile. E ke vënë re?

AJO: Po. *(Me shpresë)* Ndoshta ka ikur? Shiko nga vrima e çelësit.

(Ai shkon me të shpejtë te dera dhe kthehet i lehtësur.)

AL: Nuk ka njeri.

AJO: Çfarë lumturie! *(I hidhet në qafë.)* Nuk u mërzite, ë?

AL: As ti mos u mërzit!

AJO: A mund të largohemi tani?

AL: Sigurisht, vetëm se unë duhet të vë gjërat në vend. Me që ra fjala, mos rastësisht ke harruar ndonjë buzëkuq apo ndonjë gjë tjetër të këtij lloji?

AJO: Jo. Pa merak.

AL: Ndoshta në banjë?

AJO: Nuk kam qenë në banjë.

AL: Mirë. A të kujtohet ku ishte ky jastëk?

AJO: Aty ku është.

AL: Je e sigurt?

AJO: Po. Nuk ka lëvizur. Tani gjej një vend të fshehtë atij libri me poezi.

AL: *(E merr librin.)* Për pak e lashë këtu!

AJO: Oh, hap perdet! *(Ai hap perdet.)* Prit, ishin kështu! *(Shikon me vëmendje dhomën.)* Po, çdo gjë në rregull *(Duke marrë çantën)* Unë po nxitoj!

AL: Mirupafshim!

AJO: Takimin tjetër do ta lemë më vonë.

AL: Po.

AJO: Hape derën.

(ATA nxitojnë drejt daljes por një zile e gjatë, këmbëngulëse i ndalon. Në të njëjtën kohë bie edhe zilja e telefonit. Të hutuar dhe të dëshpëruar, ata shohin njeri-tjetrin.)

FUNDI I

HISTORISË “LEZETET E MËKATIT BASHËSHORTOR”

Historia e tretë
TAKIMI I FUNDIT

(Një dhomë e zakonshme në një shtëpi të zakonshme. Një grua e re po shtron darkën. Një zile dere. AJO shkon me qetësi për të hapur derën dhe pas një farë kohe vjen e ndjekur nga një burrë. Ai ka sjellë dy çanta të rënda me pazare.)

AL: Bleva gjithçka që kërkove me përjashtim të djathit që të pëlqen ty. S'e gjeta dot.

AJO: *(Duke e puthur në faqe)* Faleminderit. Vendosi në frigorifer, të lutem! Por, hiq njëherë këpucët dhe vish pantoflat. Sapo kam larë dyshtemenë.

(Ai heq këpucët, vesh pantoflat dhe fillon t'i shkarkojë gjërat në frigorifer.)

A dëshiron të hamë darkë menjëherë apo do të pushosh pak?

AL: Do doja menjëherë. Nuk e di pse, por më ka marrë shumë uria.

AJO: Atëhere, laj duart! *(Ai shkon në banjë, AJO shtron tavolinën.)*

A je gati?

AL: Po.

AJO: Ulu!

(Ai heq xhaketën e gravatën dhe ulet.)

Si ndihesh sot? Më mirë shpresoj?

AL: Jo. Po as më keq.

AJO: Po nga puna?

AL: Po ashtu.

AJO: *(Duke i hedhur supën)* Nuk dukesh në humor.

AL: Si zakonisht.

AJO: Një gotë verë?

AL: Po, faleminderit!

AJO: *(Nxjerr një shishe.)* Më jep pak hapsen, të lutem!

AL: Është në kuzhinë?

AJO: Po, në vendin e vet.

(Ai sjell hapsen. AJO vendos gotat në tryezë.)

AL: *(Duke hapur shishen)* Py ty, si të shkojnë gjërat?

AJO: Oh, asgjë interesante. Pak e lodhur. Kam punuar gjithë ditën.

AL: *(Do që të hedhë verën.)* Ku e ke gotën?

AJO: Unë nuk do të pij.

AL: Pse?

AJO: Nuk më pihet.

AL: Si është puna?

AJO: Jo, asgjë.

AL: Singërisht?

AJO: *(Duke buzëqeshur)* Po, i dashur. Nuk kam asgjë.

AL: Atëhere, po të hedh pak. *(Merr një gotë nga rafti dhe e mbush.)* Për çfarë do pijmë?

AJO: *(Duke ngritur gotën)* Për ty! Jetë të lumtur!

AL: Faleminderit.

(Al pi. AJO e vendos gotën të paprekur në tavolinë. Ai fillon të hajë me oreks.)

Sallata ime e preferuar.

AJO: E di. Vërtet të pëlqen?

AL: Oh, po.

AJO: Më bëhet qejfi. *(I hedh më verë.)*

AL: *(E ngre gotën.)* Këtë për ty. Jetë të lumtur, e dashur!

AJO: Faleminderit!

(Al pi. AJO e lë gotën e saj të paprekur.)

A mund ta sjell biftekun?

AL: Sigurisht. *(AJO vendos një pjatë para tij.)*

Ç'kemi ndonjë gjë të re?

AJO: Fustanin.

AL: Po. Dhe unë as që e vura re fare.

AJO: E dija se nuk do ta vije re.

AL: Eja! Çohu në këmbë! *(AJO çohet.)*

Rrotullohu, të lutem! Fantastik! Ta gëzosh! Është, padyshim, një lajm shumë i rëndësishëm

AJO: Është edhe një tjetër. Do të bëhemi me fëmijë!

AL: Po? Edhe ky është shumë i rëndësishëm. *(Ndalon së përtypuri.)* Prit pak....Përsërite, të lutem!

AJO: *(Duke buzëqeshur)* Nuk e dëgjove?

AL: Do të bëhemi fëmijë?

AJO: Po.

AL: Vërtet?

AJO: Vërtet.

AL: *(I gjallëruar)* Ky po, që është lajm!

(Vrapon tek AJO, e merr në krahë dhe e rrotullon.)

AJO: *(Duke qeshur)* Më lësho!

AL: Jo, për atë Zot!

AJO: Ti je i çmendur! Kij kujdes!

AL: *(Ndalon dhe e vendos në vend.)* Më fal! Harrova që tani, ti duhesh trajtuar me shumë kujdes.

AJO: Jo unë, fustani im. Se po të jetë për mua, mua akoma mund të mos më kursesh,

AL: Je vizituar te doktori?

AJO: Akoma jo.

AL: Po a është e sigurt? Se mos e ke gabim?

AJO: Jo. Vërtet të gëzoi ky lajm?

AL: Sigurisht! Pse ty, jo?

AJO: Ha! Se të ftohet bifteku.

AL: Vërtet duhet të pijmë! *(Hedh verë.)*

AJO: Pi.

AL: Të pijmë bashkë.

AJO: Tani, s'mundem.

AL: Oh, po...patjetër. Atëhere, as unë nuk do të pij. *(E lë gotën.)* Çfarë do që të jetë, vajzë apo djalë?

AJO: Po ti?

AL: Djalë, sigurisht. Ti e di sa shumë do doja të ishte djalë. Sa shumë do të doja të kisha një djalë!

AJO: *(Duke buzëqeshur)* Epo, do Zoti të jetë djalë, atëhere!

AL: Që të më ngjajë mua!

AJO: Djemtë, zakonisht, u ngjajnë nënave.

AL: E di, po ti do bësh të pamundurën, apo jo?

AJO: Patjetër. Je me të vërtet i lumtur?

AL: Jam shumë i lumtur! Unë i dua shumë fëmijët!

AJO: Po, e di.

AL: Kur bëhesh i vetëdijshëm se, në këtë botë, bubrron edhe një pjesë tjetër e jotja...Është vërtet e paimagjinueshme.

AJO: Po, është fantastike.

AL: Gjithë jetën kam dashur të kem një fëmijë me gruan që kam dashur.

AJO: *(Duke buzëqeshur)* Atëhere, ëndrra jote nuk do bëhet shumë shpejt realitet.

AL: Pse?

AJO: Së pari, duhet të biesh në dashuri me dikë dhe, së dyti, gjej marifetin që të mos ta ndërpresësh atë, të paktën, gjatë nëntë muajve.

AL: Ta marr si një qortim të lehtë?

AJO: Jo, vetëm shaka.

(Pauzë)

AJO: Një gotë çaj?

AL: Po, të lutem.

AJO: Një të fortë, si gjithmonë?

AL: Këtë herë jo. Kam fjetur keq edhe pa çajin.

(AJO bën çajin. Ai i hesh një sy orës së dorës.)

AJO: Duhet të shkosh në shtëpi, apo jo?

AL: Ka kohë.

AJO: Nëse duhet, më mirë të shkosh që tani. Nuk dua të bëhesh nervoz për shkakun tim.

AL: E vura gruan në dijeni se do vonohem.

AJO: Ajo, është ende në shtëpi me vajzën e sëmurë?

AL: Po.

AJO: Po të duash, mund të shkojmë bashkë në farmaci ose të blejmë ndonjë gjë tjetër që duhet.

AL: I kam blerë të gjitha. Faleminderit!

AJO: *(Duke i dhënë çajin)* Të bëftë mirë!

AL: Faleminderit!

(Ai pi çaj. AJO pastron tryezën.)

Ç'do të bësh?

AJO: Ç'do të thuash?

AL: Dua të them...Me fëmijën.

AJO: Asgjë. Ti do që të bëj diçka me të?

AL: Jo, thjesht pyeta.

AJO: Mos u shqetëso. Këto janë problemet e mija, jo tuat.

AL: Puna nuk është nëse shqetësohem unë ose jo.

AJO: Madje, unë, as nuk doja që ta thosha fare.

AL: Gjithsesi, nuk mund të fshihej.

AJO: Oh, nuk e di...Edhe për nja dy muaj të tjerë, nuk do të kishe vënë re asgjë.

AL: Po më vonë?

AJO: Askush s'e di çfarë do të ndodh më vonë.

(Pauzë e gjatë)

Fillove të biesh në mendime tani?

AL: Pse ti, jo?

AJO: Unë kam rënë në mendime shumë kohë më parë.

AL: Dhe në çfarë përfundimi ke arritur?

AJO: A mund ta heq shishen?

AL: Nuk e di. Mirë është aty.

AJO: Të sjell pak limon dhe kek të shoqëros verën?

AL: Jo, faleminderit. Megjithëse, silli. Ose jo. Vërtet nuk e di...Sa dreq çështje e komplikuar!

AJO: E ke fjalën për limonin?

AL: Jo, jo për limonin.

AJO: Më duket se të ranë puçlat edhe ty tani.

AL: Ndoshta.

AJO: Është faji im. Më fal, të lutem.

(Pauzë)

AL: Ai, e di?

AJO: Jo.

AL: Kur do t'ia thuash?

AJO: *(Duke i hedhur një shikim të hidhur)* Tani kthehet nga pushimet... Do të pres edhe pak dhe do t'ia them.

AL: Është interesante se si do ta presë.

AJO: Nuk e di. Mendoj se do të gëzohet.

AL: Nuk do t'i duket e çuditëshme?

AJO: Do ta ndreq unë që të mos i duket e çuditëshme.

AL: Faleminderit për informacionin. *(I ngrysur, pi verë.)*

AJO: Do që të mos e bëj këtë?

AL: Unë nuk dua asgjë. Vetëm se mund t'i kursesh hollësisht.

AJO: Edhe ti mund t'i kursesh pyetjet në lidhje me to.

(Pauzë. Ai fillon përsëri të pastrojë tryezën.)

AL: Pusho pak, se e bëj vetë.

AJO: Jo, i dashur, je ti që ke nevojë për pushim.

AL: Jo, jo, më lë të ndihmoj.

AJO: Meqë do...*(Ulet në sofa.)*

AL: Duhet të blejmë gjërat për fëmijën. Si thua për nesër?

AJO: Mos u ngut. Çdo gjë mund të ndodhë.

AL: Sapo ke vendosur të mos ndërmarrësh asnjë hap.

AJO: Unë nuk kam vendosur asgjë.

AL: Ku do t'ia vendosësh shtratin?

AJO: Ende nuk kam menduar për të.

AL: Pranë dritares. Është vendi më i mirë.

AJO: Është një copë muri me lagështirë pranë dritares.

AL: Po ka goxha dritë. Fëmijët kanë nevojë për diell. Po, ky është vendi i duhur. Ja, shikoje.

AJO: Po ç'ta shikoj? Unë ende nuk e di nëse do të vazhdoj të banoj këtu apo jo?

(Pauzë e shkurtër)

AL: Do që të ndahesh me të?

AJO: Ti do që unë të jetoj me të përgjithmonë?

AL: T'i çoj pjatat në kuzhinë?

AJO: Lëri siç janë. I rregulloj unë.

AL: Nuk do ta kesh të lehtë të jetosh vetëm.

AJO: Faleminderit për sinqeritetin.

AL: Ti i kupton problemet e mija.

AJO: Mos u shqetëso. Unë nuk kam ndërmend të të ndaj prej saj.

AL: Çdo hap serioz duhet peshuar mirë.

AJO: Me të nuk jetoj më.

AL: Ti më ke thënë se ai është njeri i mirë.

AJO: Është i përsosur. Po unë nuk e dua.

AL: Gjëra që ndodhin.

AJO: Dhe ç'është më e keqja, dashuroj një burrë tjetër.

AL: Kjo gjë mund të marrë fund.

AJO: Jo për mua.

AL: Se mos thyhet gota!

AJO: Mendova se mund t'i them për divorcin menjëherë sa të kthehet. Që nesër.

AL: E çfarë do t'i thuash?

(Pauzë)

AJO: Eja tani të bëjmë gjilpërën.

AL: Ndoshta sot jo.

AJO: Pse? Duhet të forcojmë sistemin tënd nervor.

AL: Nuk kam shumë besim tek gjilpëra.

AJO: Derisa ta ka dhënë mjeku, do ta bëjmë. Duhet të shërohesh.

AL: Gjilpërat nuk ta shërojnë dot ndërgjegjen.

AJO: Oh, të bren ndërgjegjë, kështu?

AL: Sigurisht.

AJO: Është interesante përse.

AL: Unë po të shkatërroj jetën.

AJO: Mos fol broçkulla.

AL: Këto janë fjalët më të arsyeshme.

AJO: Unë jam e rritur.

AL: E pastaj?

AJO: Unë vetë jam duke shkatërruar jetën time.

AL: Po të mos isha unë, ti mund të kishe një familje normale.

AJO: Unë nuk dua të kem familje normale.

AL: Po të mos isha unë, mund ta kishe dashur.

AJO: Të mos bëjmë hamëndësime.

(Pauzë)

AL: Epo mirë, çfarë do t'i thuash nesër?

AJO: *(Pas një pauze të gjatë)* Me shumë gjasë, asgjë.

AL: Pse?

AJO: Tani nuk duhet të vendos vetëm për vete.

AL: Ka gra që divorcohen, edhe pse kanë fëmijë.

AJO: Ke harruar sesa fitoj unë.

AL: Po ai do të mbështesë.

AJO: Do që t'i kërkoj para për të rritur fëmijën tënd?

AL: Më fal, fola pa menduar. Meqë ra fjala...Fëmija, është vërtet i imi?

(AJO i përgjigjet me një shikim të habitur dhe qortues.)

Më fal, fola pa menduar, përsëri.

AJO: S'ka gjë. I meritoj të tilla pyetje.

AL: Mos u acarol!

AJO: Ma jep ampulën, të lutem. Dhe përveç kësaj, ku do të banojmë, unë dhe fëmija?

AL: Besoj se do jetë aq fisnik sa të largohet nga shtëpia.

AJO: Po nuk jam unë aq e paturpshme sa ta flak nga shtëpia.

AL: Do vërtet ta bësh atë injeksionin?

AJO: Po, sigurisht. Dhe, çështja nuk qëndron as te shtëpia, as te paratë.

AL: Po ku qëndron, atëhere?

AJO: Mbi të gjitha, fëmija ka nevojë për baba.

AL: Domethënë, ke vendosur të mos ndahesh prej tij?

AJO: Do që unë të ndahem prej tij?

(Pauzë e shkurtër)

AL: Unë nuk e di se ç'dua.

AJO: Kurse unë e di, po sa para bën?

(Sjell një shiringë dhe pambuk dhe fillon të përgatisë injeksionin.)

Nuk e ke problem që i bisedoj gjithmonë gjërat me ty? Thjesht, nuk kam se me kë.

AL: Aspak.

AJO: Më sill, të lutem, alkoholin.

AL: Në një mënyrë apo në një tjetër, na duhet të vendosim diçka.

AJO: E di.

AL: Duhet t'i peshojmë të gjitha variantet. Se, në fund të fundit, nuk është se na mbeten shumë.

AJO: Vetëm tre.

AL: I pari, të vazhdosh të jetosh me të.

AJO: Unë do të preferoja me ty.

AL: Ti i kupton problemet e mija.

AJO: Me thënë të drejtën, jo dhe aq mirë.

AL: E kemi diskutuar më se një herë.

AJO: Copë muhabeti, ky variant nuk është i pranueshëm për ty.

AL: Të paktën, tani.

AJO: Pra, mbetet i fundit, të jetoj vetëm. E shikon sesa shpejt vendosim kur vendosim së bashku.

AL: Por ne sapo e sqaruam se vetëm, ti nuk mund të jetosh dot.

AJO: Ka një mundësi të katërt, të mos jetoj fare.

AL: Po bën shaka, sigurisht.

AJO: Sigurisht, po bëj shaka.

AL: Mos ndoshta është më mirë që, në këtë situatë, të mos kesh fare fëmijë?

AJO: E pastaj, çfarë?

AL: Të paktën, ti do të jesh e lirë.

AJO: Vërtet do që unë të jem e lirë?

AL: Unë dua që ti të jesh e lumtur.

AJO: Vetëm?

AL: Sa është ora?

AJO: Duhet të ikësh?

AL: Jo. Ende jo.

AJO: Si të shkojnë gjërat nga shtëpia?

AL: Keq.

AJO: Domethënë, si zakonisht?

AL: Shumë më keq. Çdo ditë, skena.

AJO: Në këtë mënyrë, ajo kërkon të të tërheq, apo jo?

AL: S'e di. Po skenat...s'kanë rëndësi.

AJO: *(Duke mbushur shiringën)* Po çfarë ka rëndësi?

AL: Gjëja më e rëndësishme është se për mua, ajo është një e huaj. Të ndihmoj?

AJO: Jo, faleminderit. E ç'mund të bëhet?

AL: Nuk e di. Asgë. Unë kërkoj qiçra në hell. *(Pi verë.)*

AJO: *(Me shiringën në dorë)* Jam gati. *(Ai shtrihet. AJO i bën injeksionin.)*

Të dhembti?

AL: Fare. Je bërë mjeshtre e vërtetë.

AJO: Po gënjen një çikë.

AL: Sa shpejt ia ke marrë dorën.

AJO: Mos harro të marrësh ampulat me vete.

AL: Për çfarë?

AJO: Nesër nuk mund të vish këtu, harrove?

AL: Ah, po. Po ampulat nuk do t'i marr.

AJO: Pse?

AL: Kush do ma bëj gjilpërën?

AJO: Kërkoja gruas.

AL: Ajo nuk merr vesh.

AJO: Të mësojë.

AL: Nuk do t'i pëlqente. Nuk është e detyruar të bëhet infermiere.

AJO: Këto, janë fjalët e saj?

AL: Po.

AJO: Mund të ngrihesh në këmbë. *(Hedh shiringën e përdorur dhe pambukun me alkohol.)* Sidoqoftë, merri ampulat. *(Pauzë)*

AL: Sa shpejt kaloi muaji.

AJO: Po.

AL: Dhe tani çdo gjë do të fillojë nga e para.

AJO: Po.

AL: Përsëri nuk do të ketë vend ku të takohemi.

AJO: Po.

AL: Dhe përsëri ti kurrë nuk do të kesh kohë.

AJO: Po.

AL: Dhe përsëri do të jetë e pamundur që unë të të telefonoj.

AJO: Edhe unë ty.

AL: Kur vjen në shtëpi ai?

AJO: Nesër në mbrëmje.

AL: Kështu që nesër, natën, ju do ta kaloni bashkë.

(AJO hesht.)

Me thënë të vërtetën, jam shumë i lodhur.

AJO: Edhe unë.

AL: Më kanë ardhur në majë të hundës takimet duke rendur.

AJO: Edhe mua.

AL: Jam i lodhur nga frika e çdo njeriu në rrugë.

AJO: Edhe unë.

AL: Jam i lodhur me jetën e dyfishtë.

AJO: Edhe unë.

AL: Më është neveritur vetja.

AJO: A do që të ndahem që nesër nga ai? *(Pauzë)*

AL: Të takon ty ta vendosësh.

AJO: Dhe unë do të vendos vetë. Po ti, do apo jo?

AL: Nuk e di.

AJO: Shpirt, më thuaj se do. Kjo nuk të ngarkon me asnjë detyrim.

AL: Do doja shumë ta thoja...

AJO: Më çliro!

AL: Ti do të ndahesh prej tij. Po pastaj?

AJO: Çfardo që të ndodhë më pastaj, ti nuk do të kesh asnjë kokëçarje.

AL: Nuk ka se si të mos kem. Ne fund të fundit, këtë, ti po e bën për mua.

AJO: Ti mos u shqetëso. Eja e më tako një herë në javë dhe, për mua, kjo do të jetë e mjaftueshme.

AL: Ti nuk do ta kesh të lehtë.

AJO: Unë do të jem shumë mirë. Do të jem vetëm e jotja.

AL: Kurse unë nuk do të jem vetëm i yti.

AJO: Nëse një herë në javë është shumë për ty, eja një herë në dhjetë ditë. Apo një herë në muaj. Një herë në sa të duash. Vetëm kështu unë do të kuptoj sesa shumë kam nevojë për ty.

AL: Po fëmija?

AJO: Sa për fëmijën, do të jetë më e lehtë, sepse ti nuk do të marrësh vesh asgjë.

AL: Dhe më e vështirë.

AJO: Vetëm ti mos u mërzit, unë nuk kam ndërmend të të kërkoj asgjë.

AL: Ti ke të drejtë të kërkojsh.

AJO: Mos fol për të drejtat dhe detyrimet. Më thuaj, ke nevojë për mua?

AL: Po . Kam nevojë për ty. *(Pauzë)* Ose, ndoshta jo. Nuk e di.

AJO: Këtë doja të dëgjoja prej teje.

AL: Besoj se nuk ofendoresh?

AJO: Jo.

AL: E di, diçka brenda meje është krisur.

AJO: E di.

AL: Ndoshta, unë nuk po të trajtoj si më parë.

AJO: E di.

AL: Jam shumë i lodhur.

AJO: Ma ke thënë.

AL: Unë mezi ç'prisja të vija tek ti, ndërkohë që më vinte keq të lija familjen.

AJO: E di.

AL: Kurse tani s'dua t'ia di për asgjë dhe s'ka mbetur asgjë që ta dua vërtet.

AJO: E di.

AL: Familja u shkatërrua... Edhe imja dhe jotja. Dhe tani, para teje ndjehem tmerrësisht fajtor.

AJO: Ti nuk je në gjendje të duash më. Do ca verë?

AL: Jo. Unë, ty, të dua ende.

AJO: Kjo "ende" do të marrë fund shumë shpejt.

AL: Ndoshta. Nuk e di. Ndoshta jam vërtet i pazoti të dua më. Përveç ndonjë kënaqësie seksuale, nuk më ka mbetur asgjë tjetër. Më vjen keq.

AJO: Për çfarë? Nëse ka njeri që është fajtor, jam unë, që kam ndenjtur duarkryq kur shihja se si ti shkatërroje vetveten dhe gjithë të tjerët rrotull teje.

AL: Unë nuk kam shkatërruar njeri.

AJO: Gjëja më e rëndësishme në botë për mua, ke qenë ti. Dhe tani, unë po të humbas. Për fajin tim. Unë e dija që në fillimi se duhej të flakja tej çdo gjë tjetër dhe të jetoja vetëm për ty, të isha vetëm e jotja. Dhe atëhere çdo gjë do të ishte ndryshe.

AL: Ndoshta. Ashtu siç janë gjërat absurde dhe qesharake.

(Pauzë. Ai hedh ca verë.)

AJO: Më vjen keq. Unë të dola hakut edhe njëherë, por ti nuk më dashuron më. A nuk je vonë për në shtëpi?

AL: Duhej të kisha ikur me kohë.

AJO: Po të përcjell. Apo s'do?

AL: S'ka nevojë. Ti je e lodhur.

AJO: As nuk dua t'ia dij. Tani do të eci çdo ditë. Më prit të vishem.

(AJO krihet para pasqyrës.)

AL: Shiko, ndoshta, ende nuk je e bindur që ta mbash fëmijën?

AJO: I dashur, nuk kam zgjidhje tjetër.

AL: Pse?

AJO: Sepse nuk ka zgjidhje tjetër.

AL: Po pse, pra, pse?

AJO: Sepse doktori më tha, o tani o kurrë.

AL: Ti nuk ke qenë te doktori.

AJO: Ma ka thënë shumë kohë më parë.

AL: Pra nuk mund të bësh asgjë, apo si?

AJO: S'mundem.

AL: Pse kështu?

AJO: Më sill këpucët, të lutem.

AL: Apo mos ishte aksidentale?

AJO: Jo. Nuk ishte aksidentale. Unë doja vetë.

AL: Nuk e kuptoj.

AJO: Më sill këpucët, të lutem.

AL: Ke krijuar vetë, me dashje, një lëmsh të madh.

AJO: E di që është një lëmsh i madh.

AL: Kur e di, pse e ke bërë?

AJO: Vërtet nuk e kupton?

AL: Vërtet, jo.

AJO: Kohët e fundit, zbulova se unë po të humbisja. Pothuajse të kisha humbur. Edhe një javë, një muaj dhe ne do të ndaheshim.

AL: Nuk e kuptoj ç'lidhje ka.

AJO: Sepse ti nuk je grua.

AL: Nuk ka nevojë të grindemi tani.

AJO: Nuk e kupton? Ne të dy mund të mos jemi më bashkë, por shëmbëlltyra jote do të jetë me mua përgjithmonë. A nuk mund të ishte edhe kjo një rrugëzgjidhje?

AL: Ti je e çmendur.

AJO: Edhe pse mund të mos shihemi kurrë, ne të dy jemi të lidhur për jetë.

AL: Më vonë, do të pendohesh.

AJO: Kurrë.

AL: Ke për ta pasur të vështirë.

AJO: Ndoshta, por në fund të fundit, për çfarë gjëje tjetër do t'ia vliente mundimi?

AL: Nuk di ç'të them.

AJO: Nuk ka nevojë të thush asgjë.

(Pauzë. Ai i jep këpucët. AJO i vesh, por pastaj i heq përsëri.)

E di çfarë? Më mirë s'po vij. Jam shumë e lodhur. Nuk të mbetet qejfi, besoj?

AL: Sigurisht, jo.

AJO: Nesër vjen im shoq....E di, doja të thosha...

AL: Çfarë?

AJO: Shumë gjëra. Por prapë s'do më dilte koha. Tani, për mua, asgjë nuk ka kuptim përveç çasteve kur jam me ty. Mosmarrveshjet, grindjet, muhabetet e kota, asgjë nuk ka rëndësi. E rëndësishme është që ti je. Dje harrove dorezat këtu. Unë ndënja ulur aty, gjithë ditën, mbulova fytyrën me to dhe s'ngopesha duke u marrë erë. Sepse ishte era e duarve të tua.

AL: Oh, e dashur....

AJO: Dhe e nesermja po vjen...por ngushëllimi im është, që ti dhe unë, kemi një djalë.

AL: Kurse mua, edhe kjo gjë, tani nuk më gëzon.

AJO: Pse?

AL: Sepse djali nuk do të jetë me mua. Unë mund të mos e shoh kurrë.

AJO: Ndoshta.

AL: Kurrë mund të mos e marr në krahë, ai kurrë mund të mos më përqafojë...Edhe mbiemrin, do ta ketë të dikujt tjetër.

AJO: Po. Dhe kjo më luan mendsh.

AL: Nuk do të më njohë kurrë.

AJO: Më vjen tmerrësisht keq!

AL: Kështu është.

AJO: Për këtë e kemi fajin vetë.

AL: Po.

AJO: Erdhi koha. *(Al vendos gravatën dhe vesh xhaketën.)*

Duket sikur vonesa nuk ka shumë rëndësi për ty.

AL: As për ty. *(E puth.)* Po shkoj.

AJO: Sigurohu që të bësh gjilpërën.

AL: Mos ngri pesha të rënda. Kujdesu për veten.

AJO: Mos harro të pish ilaçet.

AL: Kush e di se kur mund të takohemi.

AJO: Ik, tani.

FUNDI I HISTORISË
"TAKIMI I FUNDIT"